

VEPRA LETRARE E REXHEP QOSJES

Dr. Emin Kabashi
Prishtinë

KUD 92:891.983.09

1. Letërnjoftimi i kodit shkrimor

(...)

"Sepse ashtu tregojmë se ishte shkepan i letërsisë-ishte përgjegjur i pari;

Sepse ashtu tregojmë se ishte çollak i letërsisë-ishte përgjigjur i dyti;

Sepse ashtu tregojmë se ishte qorr i letërsisë-ishte përgjigjur i treti;

Sepse ashtu tregojmë se ishte shurdhan i letërsisë-ishte përgjigjur i katërti;

Sepse ashtu tregojmë se ishte hodum i letërsisë-ishte përgjigjur i pesti;

Sepse ashtu tregojmë se ishte idiot i letërsisë-ishte përgjigjur i gjashti.

A mendoni se nuk do të ishte më mirë po t'u tregonim shikuesve dhe krejt vajazanasve se ai ishte shkepan, çollak, qorr, shurdhan, hodum dhe idiot i letërsisë dhe t'u tregojmë me gjuhën e artit të vërtetë, me një figurë të madhe?

Si?- kishin pyetur të gjithë njëzërit.

Ta ngjyrosim në mënyrë alegorike, - ua kishte kthyer idhulli."(Rexhep Qosja, Vdekja më vjen prej syve të tillë, fq.290/291).

Ky kodifikim i moralit krijues brenda një kohe të caktuar kishte një konotacion çuditërisht të saktë: mesatarja e mediokriteteve krijuese ishte bërë sistem vlerash, dhe ishte çështje më vete, jo vetëm të dilje mbi këtë sistem, por edhe të bëje ndryshe nga ky sistem. Vepra letrare e Rexhep Qosjes ishte në rrjedhën e të bërit ndryshe sistemin e vlerave, do të thotë krijimit vetjak të kodit artistik, ishte në rrjedhën e të thënit ndryshe të vlerave brenda këtij sistemi, që e rrëronte nga brendë, andaj edhe atëherë kur janë shkruar (1974), edhe sot shtresimet kuptimore dhe artistike të këtij kodi, rrezatojnë tendencën e rrënimit të sistemit të vlerave të rrejshme, mediokre, meskine, të vlerave të ndërhuara mbi sistemin e iluzioneve dhe të koluareve intelektuale me mendësinë e fisnisë. Koha kur këto çështje janë thënë artistikisht dhe koha jonë, në planin e sistemit të vlerave, janë dy kohë të ndryshme. Jo vetëm pse

janë 22 vjet në mes, por, sepse: në atë kohë, sistem vlerash ishte një sistem i vënë kaherë, brenda hierarkisë shoqërore, që nuk kapërcente nivelin e trajtimit artistik të historisë së periudhës më të re. Nga kujtesa jonë bëhej përpjekje të hiqej koha e Skënderbeut, të hiqej koha e Teutës, të hiqej, koha e Pavarësisë gjysmake shqiptare, të hiqej koha e tragjedit të shumta kombëtare: shpërngulja e arbëreshëve, Lidhja e Prizrenit, ekzistimi i kolonive shqiptare kudo në botë, shpërngulja për në Turqi, e kështu me radhë. Brenda këtij sistemi vlerash hierarkia mendore dhe emocionale e njeriut, të trajtuar në veprat e gjinive të mëdha artistike, siç janë romani dhe drama, rrallë e tek kapërcente nivelin e njeriut të gatshëm të sakrifkohet për një grumbull idealesh fiktive, që nuk kishin asnjë argument shoqëror, e të mos flasim për argumentin kombëtar. Rrjedhimisht ky ishte ishte *njeriu i ri*, që mëtonte ta krijonte sistemi i vlerave që na servohej. Vepra letrare e Rexhep Qosjes, brenda atij sistemi vlerash vjen si një zë ndryshe, si një e thënë artistike ndryshe: shumë preokupuese, shumë shqetësuese, e kapshme në mjegullnajën e saj të të thënmës artistike. Diku ishte një Vajazan, e brenda tij kishte njerëz, që mendonin ndryshe, që jetonin ndryshe, që sakrifkoheshin ndryshe, që përpiqeshin për të bërë diçka ndryshe.

Në kohën tonë, në gjithë hapësirën e letërsisë shqipe, kur është rrënuar plotësisht sistemi i vlerave të djeshme, brenda sistemit të ri që po krijohet, vepra letrare e Rexhep Qosjes e ka dinjitetin e vet krijuar e artistik, vjen e rinohet, shtron probleme e hap dilema, njësoj si dje, por tashti të risimantizuara si një autonomi e krijimit artistik. Ngjashëm me mitet që ka përdorur në të tri dramat e tij: mitin e gjakmarrjes, mitin e flijimit dhe mitin e pushtetit. Duke i vënë në strukturën e dramave të tij mitetet, ai ka demitizuar përvojën iluzore historike të shqiptarit, ka rritur hapësirën e dyshimeve, të dilemave, ka zgjeruar mundësinë e frymëmarrjes artistike të letërsisë shqipe, do të thotë ka ndihmuar në emancipimin e vlerave artistike të letërsisë shqipe, veçmas të asaj që krijohej këndej kufijve të Shqipërisë londineze. Sepse, ne mund të kemi iluzione edhe sot, po realiteti kohor dëshmon këtë fakt: letërsia jonë kishte nevojë për emancipues të saj, në të dy anët e kufirit.

2. Poetika e shkrimit

Në vitet shtatëdhjetë në faqet e revistës "Jeta e re" zunë të botohen një sërë tregimesh me pseudonimin Luan Dukagjini. Në ato tregime, që me strukturën e ndërtimit të tyre kapërcenin përmasën e tregimit, lexuesi i vëmendshëm hetonte një qasje të re materialit letrar. Rrjedhimisht përmasa e jetës në to ishte tjetër, ngase ishim mësuar të lexonim në prozën e asaj kohe, veçmas të prozës që krijohej në Kosovë. Në vitin 1974, autori i këtyre tregimeve doli me një roman: "*Vdekja më vjen prej syve të tillë*", dhe ishte

njëri ndër zërat më të dalluar të mendimit kritik për letërsinë, dhe njëri nga historianët e nderuar të letërsisë, ishte Rexhep Qosja.

Romanin e Rexhep Qosjes, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, e bëjnë trembëdhjetë tregime, që i lidh një strukturë romanore e mirëfilltë: siç është personazhi, por edhe siç është niveli i shkrimit, do të thotë poetika e shkrimit. Në këto trembëdhjetë tregime romanore, shtresohen po aq kapërcej të përvojës së personazheve që bëjnë rrëfimin e ngjarjeve. Më tutje, ngjashëm me teorinë e dramës, bëjnë fakturën e trembëdhjetë situatave dramatike në jetën e personazhit bosht të romanit-Xhezairit të Gjikës. Konceptimi i këtillë i shkrimit i ka dhënë dorë autorit që të shtrojë çështje nga më të ndryshmet në jetën e njeriut: nga ato të ditës, deri te çështjet ekzistenciale, nga ato të mendësisë e të dilemave e deri tek ato të emancipimit emocional e shpirtëror. Kësisoj, rrafshi i shkrimit nuk është i njëtrajtshëm, jo vetëm pse këto trembëdhjetë tregime i kanë mundësuar, nivele e rrafshe të ndryshme shkrimi, por ngase struktura e romanit ka ndjekur një shtjellë të hapur e të pabrigje të kodit shkrimor. Zë fill ligjërimi me sintagmën - thuhet se, - në "Legjenda", "Trashja", dhe në ndonjë tjetër, që është, ta quajmë kushtimisht, mushti i shkrimit romanor në këtë vepër të Rexhep Qosjes, dhe që bën strukturën e poetikës së shkrimit në këtë roman. Një shtresim tjetër të poetikës së shkrimit bëjnë "Trilogjia", "Trekëndëshi", "Mëkata", që për mua bëjnë akribinë e shkrimit në prozë. Hapësira e interesimeve përthekon rrënojat e krijuesit që ende nuk na kishte rastisur ta lexojmë në prozën tonë. *Triologjia* mbete ndër çështjet më të guximshme në punë të shtresimeve kuptimore të ligjërimin në prozë për jetën e krijuesit. *Trekëndëshi*, ka edhe shënjeshtet e vet: Danjollin e Shërkës, Rudinën e Bardhit dhe Arifin e tëhuajzimit, që bëjnë tri shtresat e dilemave ekzistenciale dhe shpirtërore të njeriut tonë. Ngjashëm me rathët e Ferrit të Dantes, këtu të thëna me kodin shkrimor të romanit, kapërcejt e jetës së njeriut-të personazheve, bëjnë vorbullën e shtjellave që quhej jetë ekzistenciale.

Rrafshin e ligjërimin romanor, ku bashkëjetojnë sakralizimi i të keqës, *Laneti*, thyerja e kockave të shpirtit, nën peshën e dhunës, *Deklarata* dhe përvijimi i humnerës shpirtërore, që është ana e errët e kalendarit jetësor të krijujesit, *Vetmia*, e konstituojnë tri nivele ligjërimesh: rrëfimi i drejtëpërdrejtë, rrëfimi dialogjik dhe rrëfimi përimitues. Nivelet e këtilla të ligjërimin bëjnë strukturën poetike të të gjithë kapitujve të romanit, nëse trembëdhjetë tregimet, siç i ka quajtur autori i konsiderojmë trembëdhjetë kapituj. *Kryevepra*, që më thotë mendja, është niveli më i realizuar i këtij romani, është në të njëjtën kohë edhe një hyrje logjike në nivelin e rrëfimit të *Metamorfozës*. E kjo, një vijë uji për të sheshuar nivelin e *Vetvrasjës*. Ndër faqet e këtij romani, që janë fresku i këtyre niveleve ligjërimore, është pjesa *Romana*. Një kapërcyell i natyrshëm në strukturën e poetikës së këtij romani,

që vjen pas zallahisë së skëterrës jetësore të personazheve. Përmbyllja me *Herostatin*, në të njëjtën kohë është një hapje e perdës për veprën që na kishte premtuar autori, e që deri sot nuk na e përmbushi premtimin, në një anë, dhe një sipar i natyrshëm i ligjërit, ku rrathët e përvojës jetësore, të filozofisë së të mbeturit njeri, të lakadredhave ekzistenciale, të honeve të dilemave dhe të dyshimeve, përmbyllën logjikshëm. Në fund hapet kjo dilemë: logjika jetësore dhe logjika krijuese, do të thotë artistike, cila cilës i jep mushtin e ekzistencës së përjetshme, dhe a mund të krijohet autonomia e aktit krijues, pa autonominë e demiurgut të saj-krijuesit?

3. Poetika e dialogut dramaturgjik

Në dy dramat e para, *Sfinga e gjallë* dhe *Beselam pse më flijojnë*, faktura e dialogut ndërtohet mbi vargun dhe strofën, kurse në *Vdekja e një mbretëreshe*, mbi fjalinë dhe periudhën.

Në dy dramat e para ndërhyrjet e autorit, shpjegimin e situatave, sqarimin e përmbajtjeve të skenave, konceptimin e përbërësve të veprimeve skenike, i konsiderojmë strukturë të dramës, që mungojnë në dramën e tretë. Kësaj radhe, nuk do të flasim për dramën *Vdekja e një mbretëreshe*, për arsyen e vetme, sepse nuk i besojmë përkufizimit të monodramës.

Rrafshi përmbajtësor i dramës *Sfinga e gjallë*, të nxjerrë te arketipi biblikë, te vëllëzerit Habili dhe Kabili, te arketipi i luftës së përjetshme për pushtet, që në përmasën e kohës sonë, është sofistikuar si gjakmarrje, si vëllavrasje, si hakmarrje etj., që ndonjëherë edhe me përkufizimet kanunore të shqiptarëve nuk përkon mirëfilli. Andaj, drama e Rexhep Qosjes, shtreson nivele të shumëta kuptimi, u jep zë foneve të shumtë kuptimor, që bëjnë një strukturë drame, të cilën, edhe pse e kishte kultivuar drama shqipe nuk e kishte të këtij niveli, as të këtij interesimi, as të këtyre përvijimeve kuptimore. Poetika e dialogut të dramave të Rexhep Qosjes nuk e duronte ligjërimin tradicional folklorik, siç ndodhte aq shpesh kur trajtoheshin strukturat mitike në krijimtarinë tonë. Nuk e duronte as dialogun receptues të propagandës së shkollave letrare, që e kishim aq të shpeshtë në dramat e autorëve shqiptarë. Nuk e duronte as dialogun kategorizues: bardhë e zi, që ishte përbërsi kryesor i dramaturgjisë sonë. Ndoshta këtu është arsyeja, pse sot, me përmbysjen e sistemit të vlerave të djeshme, ka aq pak drama që janë krijuar në këto pesëdhjetë vjet të letërsisë shqipe, që mund të vihen në skenë. Kjo vlenë për të dy anët e kufirit të letërsisë shqipe. Dramat e Rexhep Qosjes komunikojnë sot me receptuesin edhe më përmbajtësisht se dje. Mbi këtë strukturë të ndërtimit është vënë edhe drama *Beselam, pse më flijojnë*, të cilën e mendojmë ndër realizimet me të suksesshme në mbarë dramaturgjinë shqiptare.

Struktura e dialogut dramaturgjik në dramat e Rexhep Qosjes, mendoj unë, është bërthama e realizimit të tyre artistik, nga e cila rrezatojnë gjithë ato shkëndijim planesh, shtresash kuptimore, semantike dhe artistike. Vërtet drama të dilemave të mëdha dhe të dyshimeve lodhëse, ato nuk janë drama ekzistencialiste, as të tipit të Zhan Pol Sartërit, as antidrama të tipit të Jonaskos. Beselami i dramës së Rexhep Qosjes të kujtoj tipin e heroit kryengritës kundër realitetit ekzistues, edhe pse tema e ka bërthamën te miti. Një strukturim i këtillë i poetikës së ligjërimit dramaturgjik, i ndërtuar mbi dialogun, i ka dhënë dorë autorit të sugjerojë rrafshet e caktuara të atmosferës së kohëve të ndryshme. Andaj, kufijt e përmasave të hapësirës dhe të përmasave të kohës nuk hetohen fare. Drama, si veprim konkret i personazheve, si e folur dialogjike e dy e më shumë njerëzve, ndërtohet mbi këtë parim: Sfinga sot dhe këtu, apo Beselami sot dhe këtu. Ç' i flasin këto drama receptuesit të tyre, sot dhe këtu? Këtë dilemë madhore në punë të shqyrtimit të strukturës së këtyre dramave, më së miri e shpjegon rrafshi i shtresimeve kuptimore të tyre, jo vetëm kur lexohen, por kryesisht edhe kur vihen në skenë. Receptuesit të djeshëm me siguri i kujtohen realizimet e këtyre dramave në teatrin tonë, i tillë çfarë ishte, brenda një sistemi të caktuar vlerash, shënonte një nivel tjetër të emancipimit skenik të këtij receptuesi.

Tharmi i poetikës së dialogut dramatik të këtyre veprave të Rexhep Qosjes, është liria e njeriut, do të thotë liria e individit. Normat e sjelljes së tyre, të rrugës jetësore të tyre, përpjekja për të vënë vlera të tjera më të përjetshme në shërbim të njeriut, janë ndër kushtet themelore të emancipimit të dramës shqipe, e cila përpëlitej për ta gjetur këtë rrugë, por hullitë e hapura ishin shumë të ngushta për ta zënë gjithë gjerësinë e jetës së njeriut tonë: nga mitet e te përditshmëria. Rexhep Qosja me dramat e tij e hap këtë rrugë në dramaturgjinë tonë.

